



EKSPORT

Për kryerjen e Procedurave Doganore, çdo kompani duhet të regjistrojë më parë NIPT-in në sistemin "Asycuda World".

Për regjistrimin e NIPT-it, çdo kompani duhet të paraqesë këto dokumenta:

Në rastet kur NIPT-i lëshohet nga QKR-ja

- një fotokopje të Çertifikatës së Personit të Tatueshëm
- një kopje të ekstraktit të regjistrimit në QKR

Shënim: Administratori i kompanisë mund të dergojë dokumentat e mësipërm për regjistrimin e NIPT-it dhe me email në adresat:

borxhi@dogana.gov.al

BAZA LIGJORE PËR EXPORTET E MALLRAVE

1. Regjimi i eksportit lejon që mallrat shqiptare të dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë. Eksportimi sjell zbatimin e formaliteteve të daljes, duke përfshirë edhe masat e politikës tregtare dhe, kur është rasti, detyrimet e eksportit.

2. Me përjashtim të mallrave të vendosura nën regjimin e përpunimit pasiv, të gjitha mallrat shqiptare të destinuara për eksport vendosen nën regjimin e eksportit.

3. Rastet dhe kushtet në të cilat mallrat që dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë nuk i nënshtrohen një deklarate eksporti, përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi dhe, nëse është e nevojshme, me dispozita të nxjerra nga Ministri i Financave.

4. Deklarata e eksportit duhet të depozitohet në zyrën doganore kompetente për mbikqyrjen e vendit ku është vendosur eksportuesi, ose ku mallrat janë paketuar ose ngarkuar për eksport. Në rast se është e 83 nevojshme, përjashtimet nga ky rast përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

Çlirimi i mallrave për eksport jepet me kusht që mallrat në fjalë të dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë në të njëjtën gjendje që ato ishin në datën e pranimi të deklaratës së eksportit

Dalja e mallrave: për daljen e mallrave duhen këto procedura.

- a) Formalitete para daljes së mallrave
- b) Formalitete e daljes së mallrave
- c) Eksporti dhe Ri-eksporti
- d) Njoftimi ri-eksportit

Baza ligjore që duhet shqyrtuar për eksportet janë këto

Ligji 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 236 deri 249.

VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, nenet 693 deri 718.



DOKUMENTAT

Për eksportimin e mallrave duhen këto dokumenta

- Deklaratë doganore
- Faturë
- Dokument transporti
- si dhe çdo dokument i nevojshëm për zbatimin e masave të politikës tregtare dhe ligjeve të tjera që rregullojnë eksportimin e mallrave.

